



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2582/ 9 prot.

Datë 13.11.2025

V E N D I M
Nr. 1675 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1423 /2025, datë 09.10.2025, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-61431-09-15-2025, me objekt “Blerje kënd lojrash për fëmijë” me fond limit 1,665,833 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Ankimues: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Maliq.
Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1423/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, nga autoriteti kontraktor për procedurën “E Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-61431-09-15-2025, me objekt “Blerje kënd lojrash për fëmijë” me fond limit 1,665,833 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.
 2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit sipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e dokumenteve të tenderit në SPE, sipas vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 5887 prot., datë 06.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2582/6 prot., datë 10.11.2025, autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1423/2025, datë 09.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën ardhur me nr. 5887 prot., datë 06.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2582/6 prot., datë 10.11.2025, autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1423/2025, datë 09.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit me anë të së cilës informon se nga ana e Bashkisë Maliq është zbatuar vendimi i KPP-së, duke bërë shtojcë në dokumentet standarde të Tenderit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën përkatëse për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor *Bashkia Maliq*, ka zbatuar vendimin Nr.1423/2025, datë 09.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-61431-09-15-2025, me objekt “Blerje kënd lojrash për fëmijë” me fond limit 1,665,833 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

